



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT TË NDËRMARRJES PUBLIKE KOMPANIA  
RAJONALE E UJËSJELLËSIT "PRISHTINA" SH.A. PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Publike KRU "Prishtina" sh.a., në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshëm *Arvita Zyferi-Hashani* e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Ganimete Dalloshi-Hoxhaj* (Udhëheqëse e ekipit), *Shpresa Zenelaj-Krasniqi* dhe *Xhemile Berisha-Hoti* (Anëtare të Ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Fitim Haliti*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	20
4 Qeverisja e mirë.....	44
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	48
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	57
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	60

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" sh.a.(më tutje KRU Prishtina) për vitin 2018, i cili e përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 08/01/2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i KRU Prishtina.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm


### Opinion i kundërt

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryeshefi Ekzekutiv është pajtuar me të gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të KRU Prishtina sh.a gjatë procesit të auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e “KRU Prishtina” nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (më tutje AP).

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e përgatitur dhe nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit ( ZKFTH), Kryeshefi Ekzekutiv (KE) dhe të dorëzuar për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i kundërt

Kemi audituar PFV-të e “KRU Prishtina” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese. Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Baza për Opinion të Kundërt, pasqyrat vjetore financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të KRU “Prishtina” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit akrual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

## Baza për opinion të kundërt

- Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit SNK 16, rivlerësimet duhet të bëhen në mënyrë të rregullt çdo tre ose pesë vjet, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Kompania procesin e vlerësimit të asetëve për herë të fundit e kishte realizuar në vitin 2007. Si rezultat i kësaj në regjistrin kontabël të asetëve figurojnë një numër asetesh me kosto historike në shumën 12,325,994€ e që janë të zhvlerësuara në tërësi dhe të regjistruara me vlera zero. Këto pasuri janë ende aktive dhe për të njëjtat nuk ishte bërë ri vlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre.

Çështja e rivlerësimit të asetëve ishte trajtuar edhe në raportin e auditimit financiar për vitin 2017, mirëpo ende nuk ishte përmirësuar për shkak të dështimit të procedurave të prokurimit në përzgjedhjen e kompanisë vlerësuese.

- Të dhënat kontabël duhet të jenë burim i saktë i informacionit për hartimin e pasqyrave financiare. Analizat tona tregojnë se ka diferenca ndërmjet të dhënave kontabël dhe klasave të asetëve nga regjistri i asetëve. Këto diferenca më të dukshme ishin tek klasa e strukturave ndërtimore të cilat në kontabilitet kishin koston historike për 336,398€ më pak se në regjistrin e asetëve. Ndërsa tek klasa rrejtja e ujësjellësit, në kontabilitet ishin për 336,566€ më tepër se në regjistrin e asetëve. Për më tepër, shuma totale e asetëve (vlera neto) në shënimet kontabël ishte për 3,041€ më e lartë krahasuar me regjistrin e asetëve.

Sipas konfirmimeve zyrtare, mospërputhjet e tilla janë të bartura nga viti 2015 me rastin e bartjes së të dhënave nga programi i vjetër në programin e ri të kontabilitetit dhe e njëjta gjendje është përcjellë nëpër vite.

- Sipas SNK 16 pika 50, shuma e amortizueshme e një aktivi do të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Ndërsa sipas pikës 55 të këtij standardi, amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të, që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Kompania nuk kishte zbatuar kërkesat e standardeve për zhvlerësim të asetëve që nga momenti kur asetë ishte në përdorim, mirëpo zhvlerësimi i tyre ishte bërë në bazë të kërkesave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) të bazuara në UA nr. 02/2016 për zbatimin e ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e Korporatave neni 17 pika 5<sup>1</sup>. Si rezultat i kësaj, shpenzimet e zhvlerësimit për asetet e regjistruara në vitin 2018 ishin mbivlerësuar për 165,708€. Kjo kishte ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk harton pasqyra të veçanta në bazë të kërkesave të ATK-së.

---

<sup>1</sup> Pasuritë për qëllime të zhvlerësimit merren parasysh vetëm kur ato janë të vëna në përdorim



- 
- Sipas SNK 16 pika 55, amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të, që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Projekti “Ndërtimi i sistemit për furnizim me ujë të pijshëm dhe industrial në parkun industrial në Drenas”, në shumën totale 1,047,116€, ishte donacion nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (pagesat ishin realizuar nga ministria gjatë viteve 2009-2011) e që sipas konfirmimeve zyrtare nga Kompania ishte funksionalizuar dhe ka kaluar në menaxhim të Kompanisë në gusht të vitit 2014. Mirëpo, regjistrimi i këtyre aseteve që lidhen me këtë projekt, në regjistrat e Kompanisë ishte bërë në fund të vitit 2018.

Për më tepër, këto regjistrime janë bërë me shumën që kishte projekti në vitin 2014 e jo me shumën neto të asetit që do të ishte si rezultat i zhvlerësimit për periudhën në shfrytëzim. Si pasojë e regjistrimit jo të saktë, shumën neto e këtij projekti është e mbivlerësuar për 264,236€ për zhvlerësimin e akumuluar. Mos regjistrimi i këtij projekti në kohën kur ishte funksionalizuar kishte ndodhur për shkak se Kompania nuk kishte kërkuar dokumentet përcjellëse nga Ministria.

- Sipas Ligjit Nr.06/L- 032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmimeve të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Rezultatet nga raporti i inventarizimit duhet të barazohet me librat kontabël. Kompania në fund të vitit kishte bërë numërimin e stokeve dhe kishte hartuar raportin për inventarizimin e stokeve. Mirëpo, raporti i inventarizimit nuk është barazuar me librat kontabël për stoqet të cilat gjenden në njësitë Drenas, Podujevë dhe Lipjan, si dhe për Inventarin e imët në përdorim dhe Auto Gomat në përdorim, vlera e të cilave është 152,198€. Po ashtu, komisioni i inventarizimit në raportin e tij ka evidentuar stoqe të cilat nuk janë gjetur apo janë jashtë përdorimit, por këto mos ekzistenca të stokeve apo dëmtime nuk janë korrigjuar në librat kontabël.

Përveç kësaj, në kuadër të stokeve në librin kontabël ekziston një kategori me emërtimin “Dallimet në çmime”, në shumën prej - 20,480.84€, për të cilën Kompania nuk ka informacion lidhur me burimin dhe dëshmi të shqyrtimit nga komisioni i inventarizimit. Kjo shumë është duke u bartur në librat kontabël që nga viti 2007 kur ishte bërë korporatizimi i Kompanisë. Mos harmonizimin e stokeve me evidencat kontabël, zyrtarët përgjegjës e kanë arsyetuar me faktin se këto stoqe janë të bartura në kontabilitet si total që nga viti 2007 me rastin e korporatizimit dhe e kanë konsideruar si të mjaftueshme vetëm njohjen si shpenzime me rastin e daljes nga depo.

- 
- Sipas SNK 1, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas parimit akrual. Sipas këtij parimi, të hyrat e shtyra janë të hyra të arkëtuara në avancë, dhe paraqesin detyrime që ka ndërmarrja për të kryer shërbime në të ardhmen, për shkak të shumave monetare të arkëtuara paraprakisht prej ndërmarrjes. Kështu që, në momentin e marrjes së këtyre mjeteve monetare, duke zbatuar parimin e përputhjes së të ardhurave me shpenzimet e kryera për to, ndërmarrja nuk i njeh këto arkëtime si të hyra, pasi shpenzimet për to ende nuk janë kryer. Pra, shtynë njohjen e këtyre të hyrave dhe si pasojë ato do të njihen si detyrime. Kompania, arkëtimet në avancë nga klientët e saj (që kishin parapaguar për shërbimet e ujit në të ardhmen) në shumën 172,630€, nuk i ka njohur si të hyra të shtyra - detyrime, por për këtë shumë kishte zvogëluar totalin e llogarive të arkëtueshme. Njohja e tillë ka ndikuar në nënvlerësimin e të arkëtueshmeve dhe të detyrimeve - të hyrave të shtyra për këtë shumë. Veprimet e tilla kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë për trajtimin e çështjeve në përputhje me standardet e kontabilitetit.
  - Arkëtimet në shumën prej 648,443€, nuk u janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes, por këto mjete ishin regjistruar në zërin kontabël me përshkrimin “Pagesat e dyshimta dhe të jashtëzakonshme”. Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, kjo ka ndodhur si pasojë e vështirësive në identifikimin e konsumatorëve me rastin e shkarkimit të pagesave nga llogaria bankare.
  - Të dhënat e kontabilitetit duhet të jenë burim i besueshëm për hartimin e pasqyrave financiare. Analizat tona tregojnë se llogaritë e arkëtueshme në kontabilitet dhe të prezantuara në pasqyrën e pozitës financiare në krahasim me të dhënat e modulit të shitjes ishin mbivlerësuar për 1,842,214€. Shkak për këto mospërputhje ishte neglizhenca e stafit për harmonizimin e të dhënave në mes të modulit të shitjes dhe modulit të kontabilitetit.
  - Seksioni i të arkëtueshmeve përmban zërin kontabël Kërkesat tjera, në shumën 1,828,423€. Në kuadër të këtij zëri janë përfshirë lloje të ndryshme të kërkesave ndaj të tretëve për arkëtimet e mjeteve monetare nga ana e Kompanisë, për të cilat janë identifikuar çështjet si në vijim:
    - Në kuadër të këtij zërit kontabël janë përfshirë edhe Paradhëniet në shumën 7,217€, që është vetëm një transaksion me përshkrimin “saldo e bartur nga vitit 2014”, mirëpo për këtë mungojnë shënimet analitike dhe dëshmitë përkatëse lidhur me përbërjen e tij.
    - Në kuadër të zërit Kërkesat tjera është përfshirë “Kërkesa ndaj Administratës Tatimore të Kosovës” në shumën 647,888€, mirëpo bazuar në Gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatimpaguesit dhe nga letër konfirmim për konfirmim e llogarive tatimore të pranuar nga Administrata Tatimore, vlera e kësaj llogarie tatimore është zero.
    - Në kuadër të zërit Kërkesat tjera ishin përfshirë edhe Paradhëniet për investime kapitale në shumën 571,965€, të cilat kanë të bëjnë me pagesat e situacioneve të investimeve kapitale, por ato do të duhej të prezantohen tek pasuritë si investime në vijim.
-

---

Gabimet gjatë regjistrimeve të disa transaksioneve në vitet paraprake të cilat reflektojnë edhe saldon përfundimtare, sipas zyrtarëve të kompanisë ishin shkak i parregullsive të identifikuar tek zëri kërkesat tjera.

- Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime që krijohen gjatë kryerjes së aktiviteteve kryesore të njësisë ekonomike. Ato krijohen si pasojë e blerjes së mallrave apo shërbimeve me pagesë të mëvonshme. Llogaritë e pagueshme tregtare janë të mbivlerësuara për 516,441€. Kjo shumë e mbivlerësuar i takon një furnitori të regjistruar në vitin 2016, për të cilin detyrim Kompania nuk ka arritur ta mbështesë me dëshmi përkatëse. Sipas konfirmimeve zyrtare, obligimi i Kompanisë ndaj këtij furnitori është zero, ndërsa shkak i mbivlerësimit është gabimi teknik në regjistrimet kontabël të vitit 2016.

Për më tepër, parapagimet ndaj furnitorëve për shërbimet/ furnizimet e marra në shumën 6,453€, nuk janë njohur si parapagime – pasuri, por për këtë shumë ishte zvogëluar totali i llogarive të pagueshme. Një regjistrim i tillë ka ndikuar në nënvlerësimin e të pagueshmeve dhe të pasurive.

- Seksioni i detyrimeve afatshkurtra përmban edhe zërin kontabël Tatimi i pagueshëm, në shumën prej 835,847€, në kuadër të të cilit janë përfshirë lloje të ndryshme të detyrimeve, për të cilat janë identifikuar parregullsitë si në vijim:
  - Llogaria detyrimi për pagat e pagueshme është detyrim i kompanisë për të paguar punonjësit e saj.

Detyrimet për pagat të prezantuara në bilanc janë në shumën 322,197€, detyrime këto që i takojnë muajit dhjetor 2018, por që ishin të nënvlerësuara për 19,043€.
  - Llogaria për tatimin mbi pagat dhe kontribute të pensioneve të pagueshme është llogari e detyrimeve të cilat duhet t'i paguajnë punonjësit e kompanisë. Pagesën e këtyre tatimeve punonjësit nuk e bëjnë vetë drejtpërdrejtë në zyrat fiskale shtetërore, por për llogaritë e tyre e bënë kompania ku ata punojnë. Testet tona tregojnë se detyrimet për tatime mbi pagat dhe kontributet e pensioneve ishin nënvlerësuar për 5,970€.
  - Llogaria Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH) e pagueshme është llogari e detyrimeve. Me tepërcën kreditore të kësaj llogarie tregohet detyrimi i papaguar ndaj shtetit për TVSH-në. Në bilanc ajo prezantohet në seksionin e detyrimeve afatshkurtra. Kompania detyrimet për TVSH i kishte prezantuar në shumën 287,080€. Mirëpo, analizat tona të bëra bazuar në Deklaratat tatimore, Gjendjen e përgjithshme të deklarimeve e transaksioneve tjera të tatimpaguesit dhe nga letër konfirmimi i pranuar nga Administrata Tatimore, konfirmohet se Kompania, është kreditore ndaj Administratës Tatimore, për shumën 64,226€ për këtë llogari tatimore. Diferenca ndërmjet shumës së prezantuar në bilancin e gjendjes dhe detyrimit të konfirmuar, në shumën prej 222,854€, është shumë për të cilën janë mbivlerësuar detyrimet afatshkurtra.

- Tatimi mbi të ardhurat (fitimin) e biznesit përfaqëson shumat, që i paguajnë në mënyrë të pakthyeshme buxhetit të shtetit njësitë ekonomike, në raport me fitimin apo të ardhurat e realizuara prej tyre.

Kompania ka prezantuar në bilanc detyrimet për Tatimin në Fitim në shumën 94,064€, mirëpo bazuar në Gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatimpaguesit dhe nga letër konfirmim i pranuar nga ATK, detyrimi për këtë llogari tatimore është zero. Diferenca ndërmjet shumës së prezantuar dhe asaj të konfirmuar, është në shumë prej 94,064€, për të cilën janë mbivlerësuar detyrimet afatshkurtra.

- Në kuadër të zërit tatimi i pagueshëm, është përfshirë edhe zëri detyrimet tjera ndaj punëtorëve, në shumën 51,384, shumë për të cilën kompania nuk posedon dëshmi përkatëse lidhur me përbërjen e saj.

Sipas zyrtareve të kompanisë, parregullsitë e identifikuar tek zëri tatimi i pagueshëm janë për shkak të disa gabimeve gjatë regjistrimeve të disa transaksioneve në vitet paraprake dhe që kanë të bëjnë me saldo fillestare, të cilat reflektojnë edhe saldon përfundimtare.

- Sipas SNK 37 një provizion duhet të njihet, kur njësitë ekonomike ka një obligim aktual si rezultat e një ngjarje të kaluar, mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së transferit dhe ka gjasa që të ndodh një transfer i përfitimeve ekonomike. Me rastin e njohjes së një provizionit, njihet një detyrim në pasqyrën e pozitës financiare si dhe një shpenzim në pasqyrën e të ardhurave.

Operatori ekonomik i kontraktuar për kryerjen e projektit “Ujësjetësi Komunal dhe Largimi i Kanalizimit në Prishtinë Faza III” komponenta I, kishte bërë kërkesë për kompensim të shpenzimeve të krijuara për shkak të pengesave që kanë ndikuar në mos realizimin e projektit sipas planit kohor të paraparë. Më 25 tetor 2018, Kompania kishte hyrë në një marrëveshje e cila pranon kompensimin e operatorit ekonomik në shumën 200,000€. Si rezultat i kësaj marrëveshje është krijuar një provizion, për të cilin Kompania nuk ka njohur një detyrim dhe një shpenzim për këtë shumë. Lidhur me mosnjohjen e provizionit, zyra e financave pohon se nuk ishte e njoftuar që ekziston një marrëveshje e tillë.

- Sipas SNK 20, Grantet qeveritare që lidhen me aktivet, njihen fillimisht si të hyra të shtyra dhe transferohet një pjesë në të ardhura çdo vit, duke kompensuar kështu shpenzimin më të madh të zhvlerësimit në koston fillestare. Të hyrat e shtyra janë të mbivlerësuar për shumën 264,236€, për faktin që asetet që lidhen me projektin “Ndërtimi i sistemit për furnizim me ujë të pijshëm dhe industrial në parkun industrial në Drenas”, të dhënë donacion nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ishte regjistruar me vlerë fillestare në kontabilitet në vitin 2018 edhe pse ishte në funksion nga vitit 2014. Sipas zyrtarëve të Kompanisë kjo ka ndodhur si pasojë e mos regjistrimit me kohë të asteteve të pranuar donacion dhe se këto asete ishin regjistruar sipas dokumenteve të pranuar nga ministria.

- Sipas SNK 18, të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve do të njihen kur të plotësohet përveç tjerash edhe kushti që 'shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme'. Të hyrat nga shitja në regjistrat kontabël dhe të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave nuk prezantojnë një gjendje të saktë. Në krahasim me shënimet e modulit të faturimit ato ishin mbivlerësuar për 128,130€. Kjo ka ndodhur për shkak se korrigjimet e faturave nga departamenti i shitjes nuk ishin raportuar tek departamenti i kontabilitetit me rastin e regjistrimit të tyre në librin kryesor.
- Një borxh i pa arkëtueshëm i cili është shlyer direkt nga librat kontabël mund të ndodhë të arkëtohet papritur një herë. Kur borxhi i fshirë si i pa-arkëtueshëm në njëri periudhë të kontabilitetit arkëtohet në një periudhë me vonë të kontabilitetit, shuma e arkëtuar duhet të regjistrohet si e ardhur shtesë në pasqyrën e të ardhurave në të cilën është arkëtuar pagesa. Kompania gjatë vitit 2017 kishte njohur shpenzimet të borxhit të keq, në shumën 869,929€, të cilat edhe pse ishin arkëtuar gjatë vitit 2018 nuk janë njohur si të hyra të këtij viti. Veprimet e tilla kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë për trajtimin e çështjeve kontabël në përputhje me standardet e kontabilitetit.
- Sipas Statutit të Ndërmarrjes, neni 16, Biznesi, detyrat dhe organizimi i Kompanisë duhet të bëhet sipas direktivave, mbikëqyrjes dhe përgjegjësive të Kryeshefit Ekzekutiv, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet ligjore të Kompanisë dhe vendimet e Bordit të drejtorëve (BD). Gjithashtu bazuar në matricën e aprovimeve<sup>2</sup> që specifikon ndarjen e kompetencave në mes BD dhe Menaxhmentit në pikën A4 specifikohet se bonuset propozohen nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE) ndërkaq vendimi final merret nga BD. Në mbledhjen e BD me datë 24.12.2018 Kryeshefi Ekzekutiv kishte propozuar dhënien e bonuseve për punëtorët. BD edhe pse në parim e kishte mbështetur propozimin<sup>3</sup> e KE, mirëpo ky propozim nuk ishte formalizuar me një vendim përkatës me arsyetimin se fillimisht Kompania duhet të drejtohet për interpretim dhe përgjigje me shkrim tek NJPMNP - MZHE<sup>4</sup>. Megjithatë me datë 28.12.2018 KE kishte marrë vendim për pagesën në shumën prej 200€ për çdo të punësuar të kompanisë në shumën totale 109,400€, në emër të performancës së mirë financiare përderisa Kompania gjatë vitit kishte operuar me humbje prej 751,015€. Kryeshefi Ekzekutiv marrjen e vendimit mbi autorizimet e lejuara e arsyeton me kërkesën e sindikatës në emër të punëtorëve në formë proteste, me tendencë për hyrje në grevë që do të rezultonte në mungesë të furnizimit me ujë të qytetarëve.

<sup>2</sup> E aprovuar me vendimin nga mbledhja e Bordit Drejtues të datës 02.11.2007.

<sup>3</sup> Bazuar në procesverbalin e mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të datës 24.12.2018, shumica e drejtorëve pjesëmarrës në këtë mbledhje parimisht kishin votuar për dhënien e bonuseve për stimulimin e punëtorëve ndërsa vetëm një drejtor ishte kundër.

<sup>4</sup> Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

- Sipas SNK 7, një njësi ekonomike paraqet fluksin e mjeteve të saj monetare nga aktivitetet shfrytëzuese (operative), investuese dhe financuese në mënyrën që është më e përshtatshme për biznesin e saj. Kompania tek seksioni aktivitetet operative të pasqyrës së rrjedhës së parasë kishte prezantuar shumën 571,965€, mjete këto të cilat janë paguar për investime kapitale, mirëpo ato do të duhej kategorizuar tek aktivitetet investuese. Përveç kësaj, një aset i pranuar si donacion në shumën 1,047,116€, ishte prezantuar si pagesa për aktivitete investuese edhe pse donacioni i pranuar nuk paraqet dalje të parasë.
- Sipas SNK 1 një pako e pasqyrave financiare duhet për përmbajtje edhe një pasqyrë të ndryshimeve në ekuitet e cila paraqet një përmbledhje të të gjitha ndryshimeve në ekuitet. Kompania kishte hartuar pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, mirëpo vlera totale e kësaj pasqyre krahasuar me pjesën e ekuitetit në pasqyrën e pozitës financiare ishte mbivlerësuar për 661,015€. Për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve gjatë hartimit të pasqyrave financiare ka ardhur deri tek prezantimi jo i drejtë i të dhënave të kësaj pasqyre.
- Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare prezantojnë informacionet shtesë në mënyrë që të plotësohen nevojat e përdoruesve me informacion mbi përbërjen e elementeve të bilancit dhe pasqyrës së të ardhurave. Ato zakonisht përmbajnë informacion edhe për politikën kontabël të përdorura nga njësi ekonomike për hartimin e pasqyrave financiare.

Informacioni i dhënë nga Kompania në shënimet shpjeguese për politikën kontabël të matjes së stoqeve nuk është i saktë. Aty është prezantuar se përdoret metoda e çmimit mesatar, përderisa nga të dhënat analitike për stoqet dhe konfirmimi i pranuar përdoret metoda FIFO.

Përveç kësaj, si rrjedhojë e mangësive të cilat janë identifikuar dhe prezantuar tek baza për opinion, për zërat: pasuritë jo qarkulluese, stoqet, llogaritë e arkëtueshme, kërkesat tjera, tatimi i pagueshëm, llogaritë e pagueshme, të hyrat e shtyra, të hyrat, shpenzimet, rrjedha e parasë, paraqiten mangësi edhe në shënimet shpjeguese të cilat nuk japin informacione të plota dhe të sakta.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore dhe NP në Kosovë, ZKA është i pavarur nga KRU Prishtina dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kundërt.

### **Çështjet kyçe të auditimit**

Uji i pa faturuar apo siç quhet ndryshe humbja e ujit në KRU Prishtina, e raportuar në ARRU për vitin 2018 është 58%, përderisa për vitin 2017 humbja e ujit ishte 57%. Humbjet e ujit sipas ARRU-së janë për shkak të humbjeve teknike (rrjedhjet), humbjet komerciale (lidhjet ilegale, pasaktësitë gjatë leximit të ujëmatësve, faturimi pa ujëmatës, etj.) dhe një sasi e humbjeve të autorizuara (objektet e kultit, zjarrfikësit, fontanat publike, etj.). Kompania në qershor të vitit 2018 kishte aprovuar Strategjinë për zvogëlimin e humbjeve të ujit për 2018-2022.

---

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Menaxhmenti i KRU "Prishtinës" është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit akrual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe për kontrollat e brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve , të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L- 42 për Prokurimin Publik (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përmbush edhe kërkesat si në vijim:
  - Statuti i NP-së;
  - Plani i Biznesit;
  - Raporte tremujore;
  - Raporte vjetore;
  - Raporti nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
  - Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Gjatë fazës së ndërmjetme të auditimit pas sugjerimeve tona për t'i bërë veprimet e nevojshme, kishte bërë disa korrigjime, mirëpo nuk kishte arritur t'i eliminojë gabimet në tërësi. Si pasojë e kësaj ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për opinion.

Marrë parasysh çka u tha më lart, miratimi i bërë nga KE dhe ZKFTH, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Bordin e Drejtorëve, mund të konsiderohet i pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mospajtueshmërinë si në vijim:

- Raportet tremujore të vitit 2018 vetëm pjesërisht kanë përmbushur kërkesat ligjore të nenit 31.1 dhe 31.4 të Ligjit për Ndërmarrje Publike.
  - Deri në fund të muajit shtator ishin punësuar 32 punëtorë, mirëpo këto punësime nuk ishin raportuar te pjesa e raportit ku kërkohet të prezantohet një pasqyrë e strukturës organizative e Kompanisë, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë tremujorit përkatës.



- Përveç kësaj, në raportin për tremujorin e tretë ndërmarrja nuk kishte prezantuar një përmbledhje të të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë NP-në si dhe nuk kishte prezantuar sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsye pritet që ta rrisin performancën e NP-së.

Po ashtu, aprovimi nga BD dhe dorëzimi i raporteve tremujore në NJPNMP ishte bërë me vonesë. Tremujori i parë ishte aprovuar me 13 ditë vonesë, tremujori i dytë me 11 ditë vonesë ndërsa tremujori tretë me 24 ditë vonesë, si dhe dorëzimi në NJPNMP me 19 ditë vonesë.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipërpërmendura, jepen rekomandimet:

- Rekomandimi A1** Kryesuesi i Bordit të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës i regjistrit të pasurive, dhe se janë marrë veprime konkrete përmirësuese në përputhje me standardet e kontabilitetit për: vlerësimin e pasurive; harmonizimin e aseteve në mes regjistrit të pasurive dhe shënimeve kontabël; zhvlerësimin e aseteve sipas SNK-ve dhe regjistrimin e pasurive të marra donacion me vlerën e drejtë të tyre.
- Rekomandimi A2** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që është bërë harmonizimi ndërmjet gjendjes së konstatuar të stoqeve gjatë procesit të inventarizimit me evidencat kontabël për to, për të siguruar saktësinë e vlerës së stoqeve të prezantuara në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi A3** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që zyrtarët financiar, regjistrimin e veprimeve që japin efekt në disa periudha kontabël, ta bëjnë duke u bazuar në parimin aktual duke siguruar që të hyrat e shtyra ekonomikisht maturohen (realizohen) edhe në periudhat e ardhshme kontabël.
- Rekomandimi A4** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet e menjëhershme për të identifikuar konsumatorët, mjetet monetare të të cilëve janë grumbulluar në llogarinë "Pagesat e dyshimta dhe të jashtëzakonshme" dhe se u janë zbritur obligimet e papaguara ndaj ndërmarrjes.
- Rekomandimi A5** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për harmonizimin e të dhënave ndërmjet modulit të shitjes me modulën e kontabilitetit, në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i llogarive të arkëtueshme.

- 
- Rekomandimi A6** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet korrigjuese për nën zërat e zërit “Kërkesat tjera”, për të siguruar gjendje dhe prezantim të saktë të tyre në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi A7** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për t’i korrigjuar gabimet e identifikuara në të dhënat kontabël në mënyrë që të bëhet një prezantim të saktë në pasqyrat financiare. Përveç kësaj, të krijohen mekanizma që regjistri i obligimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.
- Rekomandimi A8** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë veprimet korrigjuese që të dhënat kontabël të jenë në harmoni me gjendjen e borxheve në ATK dhe gjendjen e obligimeve tjera.
- Rekomandimi A9** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë bërë regjistrimet e sakta kontabël me rastin e krijimit të provizionit, duke njohur detyrimet dhe shpenzimet për to për të fituar një rezultat të saktë financiar.
- Rekomandimi A10** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se në listën e aseteve të cilat janë përfituar nga grantet janë përfshirë asetet me vlerën e neto të tyre në momentin e regjistrimit dhe të merren veprime korrigjuese për rastet kur vlera e tyre nuk është njohur saktë si e hyrë e shtyrë.
- Rekomandimi A11** Kryesuesi i Bordit të sigurojë krijimin e një mekanizmi që për çdo faturë të korrigjuar në departamentin e shitjes raportohet tek kontabiliteti si dhe se është bërë harmonizimi i modulit të faturimit me shitjet e deklaruara.
- Rekomandimi A12** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë bërë korrigjimet në rastin kur borxhi i keq i fshirë në njëri periudhë është arkëtuar në periudhën tjetër.
- Rekomandimi A13** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes akteve të brendshme janë krijuar mekanizma të cilët do të pamundësojnë marrjen e vendimeve pa autorizimin e organeve kompetente.
- Rekomandimi A14** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuara tek rrjedha e parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.
-

**Rekomandimi A15** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që shënimet shpjeguese të përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

**Rekomandimi A16** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që kërkesa për raportim të jashtëm të bëhet në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike, që raportet e tilla janë miratuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe se aprovimi dhe dorëzimi i tyre po bëhet brenda afatit të paraparë ligjor.

**Rekomandimi A17** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në modifikimin e opinionit. Po ashtu, të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.

Përveç kësaj, Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft pasqyrave nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD.

---

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Ndërmarrjen Publike. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të KRU Prishtinës kanë nevojë për përmirësime të mëdha pasi që pothuajse në të gjitha fushat janë identifikuar dobësi të shumta.

Menaxhimi i të hyrave ka nevojë për përmirësim. Kjo pasi që kontrollet në këtë fushë ishin të dobëta dhe kanë pamundësuar njohje të saktë të tyre në pasqyrat financiare, vonesa në legalizim të konsumatorëve, regjistrim të konsumatorëve pa i përmbushur kriteret e përcaktuara, mos aplikim të masave ndëshkuese ndaj borxhlinjeve si dhe raste të evidentimit të konsumatorëve pa përshkrim të emrit të konsumatorit dhe numrit personal.

Për më tepër, stimulimi punëtorëve në fund vit me mjete financiare në emër të performancës së mirë përderisa Kompania kishte rezultat negativ financiar, mos respektimi i afateve kohore gjatë procesit të rekrutimit të stafit, mangësitë në angazhimin e punonjësve për punë dhe detyra specifike, pagesa e shujtave pa vendim të BD, pagat e përcaktuara në rregullore me emra të punëtorëve dhe jo me pozita ishin nga mangësitë e identifikuar në fushën menaxhimit të burimeve njerëzore.

Me tutje, furnizimi me naftë pa kontratë, menaxhim i dobët i kontratave, mbivlerësimi i shpenzimeve si rezultat i keq klasifikimeve, blerja e veturave të përdorura ndikojnë në menaxhim jo të mirë të shpenzimeve.

Po ashtu, kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurive jo qarkulluese, llogarive të arkëtueshme, detyrimeve dhe kapitalit nuk janë adekuate. Ato kanë pamundësuar regjistrimin dhe raportimin e saktë dhe të plotë të këtyre llogarive si në regjistrat kontabël ashtu edhe në PFV. Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga BD për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin e Kompanisë.

### 3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme

**Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2018 (në €)**

Përshkrimi	Planifikimi fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	15,999,065	15,999,065	14,267,001	14,220,393
Të hyrat tjera	314,638	314,638	56,602 <sup>5</sup>	186,586
Të hyrat nga grantet	1,177,569	1,177,569	2,149,196	1,562,369
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>17,491,272</b>	<b>17,491,272</b>	<b>16,416,197</b>	<b>15,969,348</b>
Shpenzimet për paga	5,040,287	5,040,287	5,137,160	5,036,900
Shpenzimet për blerje të ujit të papërpunuar	657,650	657,650	642,196	425,800
Shpenzimet e energjisë	2,900,647	2,900,647	2,312,212	2,472,201
Shpenzimet e karburanteve	156,000	156,000	117,861	105,418
Shpenzimet e materialeve	699,212	699,212	739,460	501,269
Shpenzimet tjera	890,957 <sup>6</sup>	890,957	1,218,532 <sup>7</sup>	717,833
Borxhi i keq	1,483,858	1,483,858	30,437	869,929
Shpenzimet e interesit	500,000	500,000	486,637	0
<b>Gjithsej Shpenzimet</b>	<b>12,328,611</b>	<b>12,328,611</b>	<b>10,684,495</b>	<b>10,129,350</b>

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë si në vijim:

- Planifikimi i të hyrave për vitin 2018 ishte dukshëm më i lartë se realizimi për vitin 2017. Megjithatë, në fund të vitit ndërmarrja kishte arritur të realizoj 94% të shumës së planifikuar. Tejkallim të shumës së planifikuar vërehet tek të hyrat nga grantet ku shumica e planifikuar ishte tejkalluar për 82%. Kjo për shkak të gjatë vitit 2018 ndërmarrja kishte regjistruar disa asete të cilat ishin pranuar si donacion në vitet paraprake. Këto asete ishin regjistruar këtë vit dhe në bazë të kërkesave të standardeve për grantet e marra, për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet amortizimi për ato mjete.

<sup>5</sup> Në kuadër të hyrave tjera janë përfshirë edhe të hyrat nga interesi në depozitat bankare në vlerë 13,063€.

<sup>6</sup> Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në vlerë 90,076€, të dalurat financiare në vlerë 48,100€, shpenzimet e jashtme kontraktuese në vlerë 752,781€.

<sup>7</sup> Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit 117,000€, Të dalurat financiare 24,128€, shpenzimet e jashtme kontraktuese 703,808€, shpenzimet e takes së MMPH-së 365,954, shpenzimet e sportit, kulturës dhe solidare 7,642€

Megjithatë, shkallë më e ulët e realizimit në krahasim me planifikimin vërehet tek të hyrat tjera ku plani ishte përmbushur vetëm 18%.

- Shpenzimet e realizuara këtë vit në raport me planifikimin ishin 87%. Shpenzimet më të larta kishin ndodhur tek shpenzimet tjera, ku realizimi i tyre në raport me planifikimin ishte tejkaluar për 94%, për shkak të një vendimi nga MMPH për pagesë të taksës vjetore. Sa i përket shpenzimeve të borxhit të keq, në raport me planifikimin kemi një realizim më të ulët për 97%, për shkak se ndërmarrja kishte vendosur që këtë vit të njoh si borxhe të këqija vetëm borxhet e konsumatorëve për të cilët gjasa për arkëtimin e tyre ishte shumë e ulët.

## 3.2 Pasqyra e pozitës financiare

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrës së pozitës financiare, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

**Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare e KRU "Prishtina" më 31 dhjetor 2018 (në €)**

<b>Pasuritë</b>	<b>Viti 2018</b>	<b>Viti 2017</b>
Prona, Impiantet dhe Pajisjet	95,164,582	89,219,181
Investimet në vijim	0	9,527,043
<b>Pasuritë jo qarkulluese</b>	<b>95,164,582</b>	<b>98,746,224</b>
Stoqet	1,604,359	1,616,727
Llogaritë e arkëtueshme	14,023,536	13,621,326
Kërkesa tjera	1,828,423	4,136,437
Paraja në bankë dhe arkë	4,319,492	5,224,093
<b>Gjithsej Pasuritë</b>	<b>116,940,392</b>	<b>123,344,807</b>
<b>Ekuiteti</b>		
Kapitali aksionar	25,000	25,000
Rezervat	72,710,754	72,620,753
Fitimet/Humbjet e mbajtura	(9,569,759)	(10,049,648)
Fitimet/Humbjet e vitit	(751,015)	480,718
<b>Gjithsej ekuiteti</b>	<b>62,414,980</b>	<b>63,076,824</b>
<b>Detyrimet</b>		
Detyrimet afatgjata (kreditë dhe grandet e shtyra)	52,311,203	58,165,463
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe detyrimet tjera	1,378,362	1,425,046
Tatimi i pagueshëm	835,847	677,473
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>54,525,412</b>	<b>60,267,983</b>
<b>Gjithsejtë Detyrimet dhe Ekuiteti</b>	<b>116,940,392</b>	<b>123,344,807</b>

---

**Çështja A18 Mos harmonizimi në mes të regjistrit të aseteve dhe raportit të komisionit për inventarizim**

**Gjetja** Neni 7 i ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (nr. 04/L-014) në mes tjerash kërkon që shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive nëpërmjet procesit të inventarizimit dhe ky inventarizim duhet të barazohet me librat kontabël.

Kompania nuk kishte bërë harmonizimin në mes të regjistrit të aseteve dhe raportit të komisionit për inventarizim, të dorëzuar në fillim të vitit 2019 me dokumentet mbështetëse.

Sipas konfirmimeve zyrtare mungesa e procedurave të hollësishme në të cilat do të duhej të paraqiten qartë detyrat e stafit përgjegjës si dhe angazhimet e stafit në punë dhe detyra tjera ishin shkaqet e mangësive të identifikuar.

**Rreziku** Mos harmonizimi i gjendjes faktike të aseteve me regjistrat kontabël ka rezultuar me prezantime dhe shpалosje jo të duhura të aseteve në pasqyra financiare.

**Rekomandimi A18** Kryesuesi i Bordit të sigurojë është azhurnuar rregulla për menaxhim të aseteve duke përfshirë procedurat përkatëse të cilat do të shërbejnë si udhëzime të qarta çoftë për komisionet e inventarizimit e po ashtu edhe për stafin e ngarkuar për menaxhim të regjistrit të aseteve.

---

## Çështja A19 Regjistër jo i plotë i asetëve

### Gjetja

Korniza Konceptuale për Raportimin Financiar paragrafi 4.4 a), përcakton se: një aktiv është një burim i kontrolluar nga njësi ekonomike si rezultat i ngjarjeve në të shkuarën nga të cilat parashikohen përfitime ekonomike të ardhshme që do futen në njësinë ekonomike. Ndërsa, SNK 20 pika 23 parasheh që një grant qeveritar mund të jetë në formën e transferimit të një aktivi jo monetar, si p.sh., një terren ose burime të tjera, për t'u përdorur nga njësi ekonomike. Në këto rrethana është e zakonshme që të vlerësohet vlera e drejtë e aktivit jo monetar dhe të kontabilizohet si granti dhe aktivi me vlerën e drejtë.

Krahasimet tona të bëra ndërmjet regjistrit të përgjithshëm të asetëve me regjistrin e automjeteve që janë në përdorim (regjistër i menaxhuar nga njësi për menaxhim të automjeteve), rezulton se numri i automjeteve nuk përputhet. Tri vetura që sipas pohimeve zyrtare janë shitur në vitet e mëhershme, ato ende figurojnë në regjistrin e asetëve. Ndërsa, një veturë e pranuar donacion në vitin 2016, në shumë 9,817€, nuk ishte regjistruar fare në regjistrat e kontabilitetit.

Shkak i këtyre parregullsive, sipas zyrtarëve për menaxhim të asetëve ishte mos përcjellja e dokumenteve mbështetëse nga personat kompetent tek zyra e kontabilitetit. Përveç kësaj, në vitin 2018 nuk ishte realizuar një proces i veçantë i inventarizimit të veturave.

### Rreziku

Mos azhurnimi i regjistrit të asetëve ndikon në prezantim jo të saktë të asetëve duke ndikuar në nënvlerësimin/mbivlerësimin e pasurive jo qarkulluese në pasqyrën e pozitës financiare.

### Rekomandimi A19

Kryesuesi i Bordit të sigurojë e formimin e një komision për inventarizimin e veturave në mënyrë që të krijohet një regjistër i plotë i automjeteve të cilat janë në përdorim si dhe të bëhet azhurnimi i tyre në regjistrin e asetëve.



---

## Çështja A20 Vonesa në arkëtimin e akontacioneve të dhëna për punonjësit

### Gjetja

Të drejtat ndaj të tretëve (debitorë) paraqesin të drejtat e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për arkëtimin e mjeteve monetare që nuk lidhen me shitjen e mallrave/ shërbimeve nga ana e njësisë. Ato mund të paraqiten në formën e të drejtave ndaj punonjësve të njësisë për mjetet e dhëna si akontacion.

Analizat tona të zërit Kërkesat tjera në shumën 1,828,423€, tregojnë se në kuadër të tij janë edhe kërkesat nga punëtorët (kryesisht akontacione) me një shumë prej 87,332€, nga të cilat 86,732€ i përkasin periudhës 2014-2017, e që ende nuk ishin arkëtuar.

Shkak për këtë ishte neglizhenca e stafit në arkëtimin e tyre me kohë si dhe mungesa e një rregulloreje të brendshme që do t'i përcaktonte qartë masat që duhej aplikuar në raste të tilla.

### Rreziku

Mos arkëtimi apo ndalesa e këtyre mjeteve nga pagat e punëtorëve rrezikon që këto mjete të mos arkëtohen për shkak të mundësisë së përfundimit të marrëdhënies e punës me këta punëtorë.

### Rekomandimi A20

Kryesuesi i Bordit të sigurojë që brenda një afati sa më të shkurtër, menaxhmenti të ndërmarrë veprime konkrete për të hartuar dhe futur në zbatim rregullore të brendshme për akontacione apo paradhënie, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat, kushtet, mënyra dhe lartësia e shumës me rastin e kërkesës përkatësisht marrjes dhe kthimit të paradhënies (akontacionit). Përveç kësaj, të sigurojë që brenda një afati optimal shuma e mjeteve që u është dhënë punëtorëve si akontacion të arkëtohet.

---

**Çështja A21 Prezantimi i inventarit të imët në përdorim si dhe autogomat në përdorim, si stoqe**

- Gjetja** Sipas SNK 2 – Inventarët, kur ndërrmarrja bënë daljen e materialit nga depo me qëllim të përdorimit ato duhet të njihen si shpenzim në periudhën të cilën ka ndodhur dalja.
- Zëri kontabël ‘stoqet’ përshinë edhe dy kategori: Inventari i imët në përdorim dhe autogomat në përdorim, në shumën totale 71,642€, e që janë materiale të dala nga depo para vitit 2014, mirëpo nuk janë njohur si shpenzime në periudhën e ndodhjes, por mbahen ende si pasuri të Kompanisë.
- Shkak për këtë ishte se zyrtarët e ndërrmarrjes me qëllim të kontrollimit të ekzistencës së tyre si dhe eliminimit të humbjes së tyre, kanë vlerësuar si më të përshtatshëm mbajtjen e tyre si stoqe.
- Rreziku** Mos njohja e shpenzimeve me rastin e daljeve të materialeve nga depo, rezulton në mbivlerësim të pasurive dhe të fitimeve të bartura.
- Rekomandimi A21** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes Akteve të Brendshme të fuqizojë kontrollet e brendshme, me anë të të cilave do të rregullohet njohja e të gjitha shpenzimeve nga daljet e materialeve nga depo në periudhën në të cilën kanë ndodhur, që në mënyrë direkte do të rezultojë edhe në prezantimin e saktë të stoqeve në pasqyrat financiare. Po ashtu të siguroj se janë bërë korrigjimet e nevojshme lidhur me stoqet të cilat janë në përdorim.

### 3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

KRU "Prishtina" në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

**Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2018 (në €)**

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017
Të hyrat nga shërbimet e furnizimit me ujë	14,267,001	14,220,393
Te hyrat tjera operative	43,539	181,927
Të hyrat nga grantet	2,149,196	1,562,369
<b>Gjithsej të Hyrat</b>	<b>16,459,736</b>	<b>15,964,689</b>
Shpenzimet për blerje të ujit të papërpunuar	(642,196)	(425,800)
Shpenzimet e energjisë	(2,312,212)	(2,472,201)
Shpenzimet e karburanteve	(117,861)	(105,418)
Shpenzimet e personelit- Paga dhe mëditje	(5,137,160)	(5,036,900)
Shpenzimet materiale	(739,460)	(501,269)
Shërbimet e jashtme kontraktuese	(703,808)	(569,362)
Shpenzimet e taksës së MMPH <sup>8</sup>	(365,954)	0
Shpenzimet e sportit, kulturës dhe ndihma solidare	(7,642)	(5,798)
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	(117,000)	(119,429)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	(6,539,319)	(5,305,904)
Shpenzimet e provizionimit të borxhit të keq	(30,437)	(869,929)
Të dalurat financiare dhe transferi i rezultatit financiar	(24,128)	(23,244)
<b>Gjithsej Shpenzimet</b>	<b>(16,737,177)</b>	<b>(15,435,253)</b>
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	<b>(277,441)</b>	<b>529,437</b>
Të hyrat nga interesi ne depozitat bankare	13,063	4,695
Shpenzimet e interesit	(486,637)	
<b>Fitimi/Humbja para tatimit</b>	<b>(751,015)</b>	<b>534,132</b>
Tatimi në fitim		(53,413)
<b>Fitimi/Humbja neto</b>	<b>(751,015)</b>	<b>480,718</b>

<sup>8</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

## **Çështja A22 Trajtimi jo i saktë i të hyrave nga grantet**

- Gjetja** Sipas SNK 20, grantet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet amortizimi për ato mjete.
- Analizat e bëra tregojnë se për tri asete që kishin vlerën zero në fund të vitit 2017, Kompania kishte njohur shpenzime zhvlerësimi përkatësisht të hyra nga grantet edhe për vitin 2018, në shumën 63,468€. Njohja e tillë ka mbivlerësuar të hyrat nga grantet.
- Kjo ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë së zyrtarëve gjatë zhvlerësimit të aseteve.
- Rreziku** Njohja e shpenzimeve të zhvlerësimit për asetet me vlerë të mbetur zero, të cilat rrjedhimisht kanë ndikim tek të hyrat nga grantet ndikon në rezultatin financiar të ndërmarrjes.
- Rekomandimi A22** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se korrigjimin e transaksioneve të cilat kanë të bëjnë me të hyrat nga grantet dhe në rastet kur vlera e asteve është zero të mos lejohet zhvlerësimi i tyre.

---

## Çështja A23 Vonesa në regjistrimin e ujëmatësve të konsumatorëve individual

**Gjetja** Rregullorja nr. 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit, në nenet 12-14 përcakton procesin dhe afatet kohore në bazë të cilave duhet të bëhet procedimi i aplikacioneve për lidhje dhe regjistrim në sistemin e faturimit. Procedura për lidhjen e të aplikuarve në rrjetin e ujit dhe kanalizimit duhet të përfundohet brenda 15 ditëve kalendarike.

Brenda tre viteve të fundit kërkesë për legalizim të ujëmatësve individual kishin paraqitur 83 investitor të banimeve kolektive. Në 12 mostra të testuara kemi vërejtur që në të gjitha rastet procedurat e legalizimit ishin vonuar dhe variojnë nga një muaj deri në një vit. Ndërsa, në dy raste edhe pse kërkesat ishin bërë që nga muaji prill respektivisht shtator të vitit 2018, ende nuk ishte bërë verifikimi i këtyre kërkesave nga komisioni i angazhuar për verifikim të gjendjes në teren.

Mos përmirësimi i gjendjes nga vet investitorët pas vërejtjeve të pranuar nga komisioni i verifikimit, ishte shkak kryesor për vonesat në verifikim dhe regjistrim të konsumatorëve.

**Rreziku** Vonesat në procesin e legalizimit apo regjistrimit të këtyre konsumatorëve përveç që janë në kundërshtim me rregulloren, shkaktojnë mos faturim të të hyrave në periudhën kur ofrohet shërbimi dhe rritjen e humbjeve të ujit.

**Rekomandimi A23** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që në rastet e mos përmbushjes së obligimeve të konsumatorëve në përmirësimin e gjendjes pas vërejtjeve të komisionit, duhet të aplikohen masa konkrete si ndëshkimet ose shkyçjet e tyre, në mënyrë që regjistrimi i konsumatorëve të bëhet në periudhën kur ofrohet shërbimi.

---

## Çështja A24 Regjistrimi i konsumatorëve pa i përmbushur kriteret e përcaktuara

### Gjetja

Sipas Rregullores nr.02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit të aprovuar nga ARRU<sup>9</sup>, parashihet që konsumatorët duhet të përcaktojnë një lokacion të përshtatshëm për vendosjen e ujëmatësve dhe në rast të mos plotësimit të kësaj kërkesë, ofruesi i shërbimit mund të refuzoj ofrimin e shërbimeve ose të suspendoj shërbimet për këta konsumator.

Brenda tre viteve të fundit kërkesë për legalizim të ujëmatësve individual kishin paraqitur 83 investitor të banimeve kolektive. Gjatë trajtimit të kësaj çështje, kemi vërejtur që menaxhmenti i Kompanisë, në janar të vitit 2019 kishte marrë vendim për regjistrim të të gjithë konsumatorëve që janë të pajisur me ujëmatës individual, të cilët kanë aplikuar përmes investitorëve në objekte kolektive. Nga gjithsej 25 objekte kolektive, që legalizohen në bazë të këtij vendimi, ne kemi trajtuar pesë raste. Gjatë shqyrtimit të vërejtjeve të dërguara këtyre investitorëve nga komisioni i ndërmarrjes, kemi vërejtur që ujëmatësit kryesorë, nuk i plotësonin standardet e përcaktuara, ndërsa në dy raste vërejtjet ishin dhënë edhe për disa ujëmatës individual. Pavarësisht kësaj, në janar të vitit 2019 ishin regjistruar 245 konsumatorë, që janë pjesë e këtyre objekteve kolektive.

Sipas zyrtarëve të Kompanisë, regjistrimi i këtyre konsumatorëve individual pavarësisht që investitorët nuk i kishin plotësuar të gjitha kriteret, ishte bërë me qëllim të mënjanimin të vonësive në faturimin e të hyrave për shërbimin e ofruar dhe të mos grumbullimit të mëtejshëm të borxheve për konsumatorët.

### Rreziku

Legalizimi i konsumatorëve pa i plotësuar të gjitha kriteret, mund të ketë për pasojë keqpërdorimin e ujit nga investitorët dhe konsumatorët duke pasur ndikim në mos faturim të konsumatorëve për shërbimet e ofruara, rrjedhimisht edhe në rritjen e humbjeve të ujit.

**Rekomandimi A24** Kryesuesi i Bordit të sigurojë formimin e një komisioni përkatës për verifikimin e të gjithë konsumatorëve të rinj të regjistruar, për të konfirmuar nëse këta konsumatorë kanë zbatuar vërejtjet e komisionit. Në rastet kur ujëmatësit nuk i plotësojnë standardet e kërkuara, brenda një afati sa më të shkurtër kohor të bëhet shkyçja e tyre.

---

<sup>9</sup> Autoriteti Rregullator i Ujit

---

**Çështja A25 Të dhënat e konsumatorëve jo në përputhje me rregullat e ARRU-së**

Rregullorja e ARRU-së nr.03/2016 për kartën e konsumatorit të shërbimeve të ujit në Kosovë, parasheh që regjistri i konsumatorëve ndër të tjera duhet të përmbajë: numrin personal dhe emrin e konsumatorit.

Në regjistrin e konsumatorëve ekzistojnë 489 konsumatorë të cilëve ju mungon numri personal dhe emri i konsumatorit. Këta konsumatorë janë evidentuar me përshkrimin "NN" dhe shuma që këta konsumatorë i detyrohen Kompanisë është 134,137€.

Sipas zyrtareve të Kompanisë regjistrimi i konsumatorëve me përshkrimin "NN" ka ndodhur kryesisht për shkak të kërkesës së investitorëve të objekteve kolektive për apartamentet e pa shituara, në mënyrë që të mos bëhet ngarkesa me borxh në emër të investitorëve deri në shitjen e tyre.

**Rreziku**

Evidentimi i konsumatorëve pa përshkrim të emrit të konsumatorit dhe numrit personal, krijon pa pajtueshmëri ligjore dhe rrezikon mos arkëtim të mjeteve për shkak të pamundësisë se aplikimit të masave ligjore ndaj këtyre borxhlinjve.

**Rekomandimi A25**

Kryesuesi i Bordit të sigurojë që brenda një afati të përcaktuar kohor të shqyrtojë dhe të marrë masat përmirësuese, në mënyrë që të gjithë konsumatorët e evidentuar me emërtimin "NN" të regjistrohen në emër të shfrytëzuesve të shërbimit. Për më tepër, të sigurohet që shuma kreditore e evidentuar përcaktohet për secilin prej tyre dhe se po merren masat e nevojshme për arkëtime.

---

**Çështja A26 Faturimi i konsumatorëve jo në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ARRU****Gjetja**

Sipas vendimit të ARRU-së nr. 169 për aprovimin e ngarkesës për faturimin e konsumatorëve në rastet pa ujëmatës, faturimi aprovohet vetëm për konsumatorët shtëpiak në ndërtesat e banimeve kolektive-apartamente. Të gjitha kategoritë tjera të konsumatorëve duhet të faturohen në bazë të leximit të ujëmatësit, në të kundërtën do të shkyçen.

Kompania ende bënë faturime pa matje në mënyrë paushalle, për konsumatorët të cilët nuk kishin të instaluar ujëmatës. Numri i konsumatorëve të tillë lëvizë prej 1,628 në muajin janar deri 1,090 në muajin dhjetor (këtu nuk janë përfshirë konsumatorët shtëpiak të banimeve kolektive - apartamente). Shuma e këtyre faturimeve arrin në 260,802€, mirëpo sasia e ujit për m<sup>3</sup> e cila faturohet paushall nuk ishte e aprovuar nga ARRU.

Sipas menaxherit të shitjes, ky lloj faturimi bëhet në rastet kur ka vështirësi në leximin e ujëmatësit. Ndërsa mos shkyçja e këtyre konsumatorëve ka ndodhur për shkak se kapacitetet ekzistuese të personelit kanë qenë më shumë të fokusuara drejt arkëtimit të borxheve, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrjedhjeve të ujit përgjatë gjithë rrjetit shpërndarës të ndërmarrjes.

**Rreziku**

Faturimi pa matje apo paushall rrezikon që sasia e konsumuar e ujit të mos jetë e saktë dhe sasia e pa faturuar të reflektoj në rritjen e humbjeve të ujit e cila ndikon në rezultatin financiar të ndërmarrjes.

**Rekomandimi A26**

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj hartimin e një plani të veprimit për marrjen e masave të ndërprerjes së faturimit në mënyrë paushallë, duke siguruar mënyrën për instalimin e ujëmatësve tek të gjithë këta konsumatorë, afatet kohore dhe masat ndëshkuese për rastet kur nuk bëhet instalimi i ujëmatësve.



---

**Çështja A27 Mos aplikimi i masave ndëshkuese ndaj konsumatorëve borxhlinj****Gjetja**

Rregullorja për procedurat e faturimit për shërbimet e ujit, neni 11.1, përcakton se nëse pagesa nuk bëhet brenda afatit të cekur në faturë, kompania do të procedoj vërejtjen e 2-të, përmes së cilës obligohet konsumatori që brenda 5 ditëve të punës të bëjë pagesën ose do të pasojë ndërprerja. Pas këtij afati Kompania do të iniciojë procedurën e përmbartimit. Ndërsa urdhëresa për tarifën e shërbimit përcakton tarifën prej 3€ për dërgimin e vërejtjeve.

Pas analizës së bërë në lidhje me borxhet e konsumatorëve, është vërejtur se për 13,773 konsumator, borxhi i të cilëve në fund të vitit ishte 500€ dhe që nuk kishin kryer asnjë pagesë gjatë vitit, Kompania nuk kishte proceduar vërejtje për mos pagesë të borxhit për këta konsumatorë dhe rrjedhimisht mos faturim në vlerë 41,319€ për mos procedim të vërejtjeve.

Për tepër, për 10,670 konsumator me borxh mbi 1,000€, të cilët nuk kanë kryer asnjë pagesë gjatë vitit, Kompania nuk ka ndërmarrë veprime për arkëtimin e borxheve nëpërmjet procedurave të përmbartimit.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes si vërejtje merret edhe fatura, ku në pjesën mbrapa faturës informohet çdo konsumator për mënyrën e pagesës dhe se apel për pagesë konsumatorëve borxhli u është bërë edhe përmes mjeteve të informimit publik. Ndërsa sa i përket procedurave përmbartimore kemi mungesë të informacioneve sidomos të numrit personal të konsumatorëve sepse pa këto të dhëna zyra përmbartimore nuk mund të procedoj lëndën për përmbartim.

**Rreziku**

Mos dërgimi i vërejtjeve ndaj borxhlinjve ndikon në uljen inkasimit dhe të hyrave, rrjedhimisht kjo ndikon në uljen e rezultatit financiar. Po ashtu, mos aplikimi i procedurave përmbartimore rrezikon vjetërsimin e borxhit dhe mos arkëtimin e tyre.

**Rekomandimi A27**

Kryesuesi i Bordit të sigurojë që regjistri i konsumatorëve të plotësohet me të gjitha informatat e konsumatorëve, të merren masa ndaj konsumatorëve të cilët nuk i përgjigjen kërkesave për pagesë, të dërgoj vërejtjet dhe në rastet kur konsumatorët nuk i përgjigjen vërejtjeve të aplikohen procedurat përmbartimore.

---

**Çështja A28 Mos respektimi i afateve kohore gjatë procesit të rekrutimit të stafit**

- Gjetja** Udhëzimi Administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, obligon çdo punëdhënës të respektoj afatet kohore të përcaktuara për faza të ndryshme të procesit të rekrutimit të punonjësve.
- Trajtimi i jonë për procedurat e rekrutimit ka nxjerrë në përfundim se për pesë procedura ka vonesa në respektimin e afateve kohore pas mbylljes së konkursit, në disa raste deri në 30 ditë.
- Kjo ka ndodhur për shkak që personat përgjegjës për caktimin e komisionit dhe personat e caktuar në komisionin për përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm ishin të angazhuar me punë dhe përgjegjësi të tjera.
- Rreziku** Mos respektimi i afateve kohore gjatë procesit të rekrutimit mund të ndikojë në dështimin e proceseve të rekrutimit në rast të ankesave si dhe vonesë në arritjen e objektivave të ndërmarrjes.
- Rekomandimi A28** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që me rastin e formimit të komisioneve të përzgjedhjes së kandidatëve të respektohen afatet kohore dhe gjatë periudhës kur këta të fundit janë të angazhuar në komisione, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të delegohen tek stafi tjetër duke u siguruar që puna e tyre të realizohet brenda afateve kohore, siç është përcaktuar me ligj.

---

**Çështja A29 Angazhimi i punonjësve për punë dhe detyra specifike më tepër se sa periudha e përcaktuar me ligj****Gjetja**

Ligji i Punës obligon punëdhënësin e sektorit publik: të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës, të lidhë kontratë pune në formë të shkruar dhe të nënshkruar nga punëdhënësi dhe i punësuarit dhe se kontrata për punë dhe detyra specifike, nuk mund të jetë më gjatë se 120 ditë brenda një viti. Gjithashtu ky ligj përcakton se të punësuarve për punë dhe detyra specifike nuk i takon pushimi vjetor dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kontratë kolektive dhe Kontratën e Punës.

Për pozitën e punës sigurimi fizik, me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv, ishin angazhuar tre punonjës për punë dhe detyra specifike pa zhvilluar procedura të rekrutimit, ku dy prej tyre gjatë periudhës janar-mars kanë punuar dhe janë paguar pa kontratë të lidhur ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit.

Për me tepër, pas lidhjes së kontratës për punë dhe detyra specifike me afat 120 ditë, angazhimi i tyre kishte zgjatë 116 ditë më tepër se që është përcaktuar me ligj.

Ndërkaq njëri prej punonjësve ka qenë i angazhuar me kontratë për punë dhe detyra specifike nga 25.12.2017-24.04.2018, ka punuar deri në fund të vitit 2018 pa kontratë pune si dhe 251 ditë më shumë se periudha e lejuar me ligj. Përveç kësaj, këta të punësuar kishin përfituar shtesat për shujta, për punën gjatë festave si dhe punën gjatë natës.

Angazhimi i punonjësve në pozitën sigurim fizik, kishte ndodhur për shkak të ndërprerjes së kontratës me kompaninë e sigurimit për mos përmbushje të obligimeve. Tejkalimi i afatit ligjor për këto angazhime kishte ndodhur për shkak të anulimit të procedurave të rregullta të rekrutimit. Ndërsa, pagesat e shtesave në kundërshtim me ligjin kishin ndodhur për arsye se ndërmarrja këta të punësuar i ka konsideruar punëtorë të rregullt.

**Rreziku**

Parregullsitë e identifikuara me lartë rrezikojnë që të angazhohen personat jo kompetent për pozitat përkatëse dhe kjo mund të rezultojë në mos efikasitet operacional.

**Rekomandimi A29**

Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes Akteve të brendshme të ndërmarrjes të fuqizoj kontrollin e brendshme, të cilat do të pamundësonin angazhimin e stafit pa proces konkurrues, pagesën e pagave dhe benefiteve tjera pa dokumente mbështetëse (kontrata të punës), si dhe kontratat për punë dhe detyra specifike të lidhen deri në afatet maksimale të lejuara me ligj.

---

**Çështja A30 Mangësi në Rregulloren e pagave të punonjësve**

- Gjetja** Bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së pagave të punonjësve të aprovuar nga BD gjatë vitit 2015, vlera e pagës së punëtorëve në kontratën e punës duhet të përcaktohet bazuar në këtë rregullore.
- Dhjetë punonjës të cilët mbajnë pozita të ndryshme, emrat e tyre nuk figurojnë në listën e koeficienteve të pagave të Rregullores në fuqi, që duhet të ishte bazë mbështetëse për përcaktimin e pagës.
- Përveç kësaj, në pesë raste paga e punëtorëve e përcaktuar në kontratën e punës dallon nga paga e përcaktuar në rregulloren e pagave të punonjësve, kjo si rezultat i ndryshimit të pozitave të tyre.
- Mungesa e punëtorëve në listën e koeficienteve të pagave që është pjesë e rregullores, ka ndodhur për arsyeje se pagat në rregullore janë përcaktuar me emra të punëtorëve dhe jo me pozita, dhe se marrëdhënia e punës me këta punëtorë ishte lidhur pas aprovimit të kësaj rregulloreje.
- Rreziku** Mos përcaktimi i pagave në rregullore për punëtorët e ri të ndërmarrjes, rrezikon që këta punëtorë të shpërblehen me pagë më të lartë se do të duhej për pozitën përkatëse. Ndërsa, përcaktimi i koeficienteve në bazë të emrave të punonjësve dhe jo pozitave të punës shkakton parregullsi gjatë sistemimit të punonjësve në pozita të ndryshme të punës.
- Rekomandimi A30** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është bërë azhurnimi i Rregullores së pagave të punonjësve, duke përcaktuar koeficientet e pagave bazuar në pozitë, konform strukturës organizative të ndërmarrjes.

---

**Çështja A31 Mos harmonizimi i koeficientit të pagës në mes të rregullores së pagave dhe kontratës së punës**

**Gjetja** Statuti i Ndërmarrjes, neni 7 obligon ndërmarrjen që të nxjerrë rregullore, të cilat përmbajnë dispozitat për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë, të cilat duhet të miratohen, mund të ndryshohen apo të revokohen vetëm nga aksionarët ose bordi drejtues i ndërmarrjes.

Testimet tona në një rast tregojnë se koeficienti i përcaktuar në rregullore dhe kontratë të punës ishte më i ulët se pagesa e pagave për këtë punëtor. Ky ndryshim është bazuar në një vendim për përmirësimin e gabimeve të komisionit për nivelizim dhe sistematizim të pagave, aprovuar nga ZKF dhe KE (të cilët nuk kanë qene pjesë e komisionit). Vendimi ka të bëjë me ndryshimin e rregullores së pagave, që është kompetencë e Bordit Drejtues sipas Statutit të Ndërmarrjes.

Kjo ka ndodhur për shkak të ankesës së punëtorëve pas ekzekutimit të vendimit për nivelizimin e pagave, të cilat janë vlerësuar nga ZKF dhe KE si të bazuara.

**Rreziku** Përcaktimi i pagave për punonjës të caktuar nga ana e menaxhmentit duke qenë në kundërshtim me rregulloret e miratuara nga autoriteti i autorizuar për miratimin dhe ndryshimin e tyre, përveç që ndikon në pagesa të parregullta mund të sjell demotivim tek punonjësit tjerë të cilët kryejnë punën e njëjtë duke rrezikuar kështu cilësinë e punës.

**Rekomandimi A31** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes Akteve të Brendshme të ndërmarrjes të fuqizojë kontrollet e brendshme, të cilat do të siguronin respektimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Bordi Drejtues i Ndërmarrjes.

---

## Çështja A32 Keq klasifikimi i zërave kontabël

- Gjetja** Sipas SNK<sup>10</sup> 16 përcakton që, një pajisje të konsiderohet zë material duhet ti plotësoj disa kriteret: të mbahet për përdorim në prodhimin ose furnizimin e të mirave ose shërbimeve, për dhënie me qira të tretëve ose për qëllime administrative dhe pritet që të përdoret më gjatë se një periudhë.
- Kompania kishte regjistruar si shpenzim të materialit harxhues 10 kontejnerë të klorit të gaztë me kapacitet 800 litra në vlerë totale 35,344€, edhe pse këta kontejnerë i plotësojnë kriteret për tu regjistruar si pajisje (asete) të kompanisë.
- Keq klasifikimi i zërave financiar ka ndodhur për shkak se me këto pajisje kompania ishte furnizuar në vitin 2015 dhe në atë vit janë regjistruar gabimisht si stoke-material harxhues. Si rrjedhojë, gabimi është bartur edhe në regjistrimin kontabël në vitin 2018 me rastin e vënies në përdorim të këtyre pajisjeve.
- Rreziku** Mos regjistrimi i saktë i zërave financiar rezulton me mbivlerësim të shpenzimeve dhe nënvlerësim të aseteve, rrjedhimisht kjo ndikon edhe në mos prezantim të saktë të PVF-ve.
- Rekomandimi A32** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që bëhen korrigjimet e nevojshme për gabimet e identifikuar dhe të sigurohet që mekanizmat e vendosura të kontrollit për verifikimin e regjistrimeve të transaksioneve të jenë funksionale në mënyrë që gabimet e tilla të parandalohen duke minimizuar mundësinë e keq deklarimeve materiale në pasqyra.

---

<sup>10</sup> Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit

## Çështja A33 Prokurimi i mallrave të përdorura

### Gjetja

Ligji i Prokurimit Publik nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë që përcakton prokurimin e mallrave të përdorura. Megjithatë, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në sqarimet e dhëna tek pyetjet e shpeshta, përgjigjeje këto të prezantuara në web-faqen e saj në lidhje me këtë temë, sqaron se pavarësisht që ligji i prokurimit nuk e ndalon prokurimin e mallrave të përdorura një gjë e tillë nuk rekomandohet. Arsyetimi për këtë është se specifikimet teknike të vendosura nga Autoriteti Kontraktues (AK) nuk garantojnë domosdoshmërisht se dy apo më shumë mallra që kanë të njëjtat specifika teknike kanë edhe kapacitetet e njëjta në kushtet e performancës dhe funksionalitetit. Për më tepër, prokurimi i mallrave të përdorura mbetet nën përgjegjësin e Autoritetit Kontraktues (AK).

Ndërsa, neni 6 i LPP përcakton se të gjitha AK, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Kompania kishte bërë njoftimin për kontratë së bashku me dosje të tenderit për procedurën "Furnizim me Vetura të Përdorura". Mirëpo, pavarësisht që Zyra e Prokurimit i kishte njoftuar menaxhmentin e Kompanisë lidhur me interpretimet e KRPP-së për prokurimet e mallrave të përdorura, ZKF dhe KE kishin autorizuar inicimin e kësaj procedure përmes nënshkrimit të DNPDPF<sup>11</sup>.

Sipas raportit të vlerësimit të ofertave (datë 20.12.2018) OE që kishte ofertuar, i plotësonte të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe është rekomanduar për nënshkrim të kontratës. Në bazë të ofertës së fituesit të bazuar në dosje të tenderit, ndërmarrja do të furnizohet me tre vetura Karavan (vlera 31,770€), tre vetura PICKUP (vlera 23,940€) dhe tre rimorikio (vlera 7,740€). Vlera totale e automjeteve është 63,451€. Kontrata me OE fitues ishte nënshkruar me datë 14.01.2019.

Sipas arsyeve të dhëna në DNPDPF me furnizimin me automjete të përdorura lehtësohet puna operative e departamenteve dhe njësisë të Kompanisë.

<sup>11</sup> Deklarata e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Fondeve

**Rreziku** Prokurimi i mallrave të përdorura mund të ndikojnë në cilësinë, performancën dhe funksionalitetin e mallrave dhe mund të ndikojnë në blerje krejtësisht jo efektive për autoritetin kontraktues. Kjo është për shkak të faktit të paparashikueshëm dhe të pa kontrollueshëm të krahasimit nëse një produkt është në gjendje më të mirë se tjetri. Pamundësia për të krahasuar dy tenderë identik do të përbëjë një shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të konkurrentëve. Përveç kësaj, blerja e produkteve të përdorura vë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve/produkteve të pranuar për parane e dhënë duke ndikuar që ndërmarrja të paguajë çmime jo konkurruese për produkte të tilla.

**Rekomandimi A33** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që para inicimit të procedurave të prokurimit nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. Përveç kësaj, kriteret teknike duhet të sigurojnë që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë i barabartë dhe jo-diskriminues.

### Çështja A34 Furnizimi me naftë pas skadimit të kontratës

**Gjetja** Ligji për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë, neni 3, i obligon ndërmarrjet publike, që asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këfillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.

Me rastin e trajtimit nga ana e jonë të procesit të implementimit të kontratës publike "Furnizim me Naftë dhe Benzinë", është vërejtur që Kompania ishte furnizuar me 4,000 litra naftë në vlerë 3,360€, gjashtë ditë para nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik.

Sipas Menaxherit të Autoparkut, kjo kishte ndodhur si rezultat i paraqitjes së nevojave urgjente të furnizimit me naftë, për shkak të mungesës së rezervave të naftës dhe kjo gjendje pamundësonte funksionimin e njësiteve të operativës.

**Rreziku** Furnizimet pa kontratë e rrisin rrezikun e furnizimeve me çmime më të larta, si dhe para lidhjes së kontratave për shkak të ankesave të operatorëve, aktivitetet e prokurimit mund të anulohen. Kjo më pas, rezulton me hyrje në obligime me operatorët ekonomik të cilët nuk janë të shpërblyer me kontratë.

**Rekomandimi A34** Kryesuesi i Bordit duhet sigurojë se janë hartuar politika të brendshme për përcaktimin e kufijve minimal të rezervave të naftës si dhe para skadimit të kontratave, brenda një periudhë të përshtatshme kohore, të fillojnë procedurat e prokurimit për të mundësuar lidhjen e kontratave të reja me kohë.



**Çështja A35 Nënshkrimi i kontratës publike kornizë me Operator Ekonomik të papërshtatshëm**

**Gjetja** Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, neni 27.3, specifikon që secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të specifikuara në nenin 65 i LPP<sup>12</sup>-së.

Kompania kishte nënshkruar kontratë publike kornizë për shërbime të Gastronomisë (pije dhe ushqim) me grup të operatorëve ekonomik edhe pse njëri nga operatorët si partner i grupit nuk kishte ofruar dëshmi lidhur me vërtetimin e pagesës së tatimit dhe as një dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se gjatë dy viteve të kaluara nuk është shpallur si i falimentuar ose insolvent, siç kërkohet me nenin 65 të LPP.

Për veç kësaj, operatori ekonomik fitues nuk kishte ofruar librezat sanitare për punonjësit që kryejnë shërbimin, të vlefshme jo më të vjetra se 6 muaj nga IKSHPK<sup>13</sup>, gjë që ishte kërkesë në specifikimet teknike në dosjen e tenderit.

Shkak i parregullsive të tilla ishte neglizhenca ose pakujdesia e zyrtarëve kompetent për nënshkrimin dhe menaxhimin e kontratës.

**Rreziku** Mos përmbushja e kërkesave të përshtatshmërisë dhe specifikimeve teknike të dosjes së tenderit, mund të shpie deri tek nënshkrimi i kontratave publike me operator të cilët nuk kanë përmbushur obligimet ligjore.

**Rekomandimi A35** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që me rastin e nënshkrimit të çdo kontrate publike të respektohen kërkesat ligjore në mënyrë të plotë dhe me kontratë publike të shpërblehen, vetëm operatorët të cilët kanë përmbushur gjitha kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit.

### 3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të ndërmarrjes, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

**Tabela 4: Kapitali i Ndërmarrjes publike më 31.12.2018**

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>KAPITALI</b>		
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezervë	72,710,753	72,620,753
Fitimet/Humbjet e bartura	(9,568,929)	(10,049,648)
Fitimet/Humbja e vitit aktual	(751,015)	480,718

<sup>12</sup> Ligji i Prokurimit Publik

<sup>13</sup> Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

### 3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve operative, investive dhe ato financiare. Informatat rreth rrjedhës së parave të kompanisë janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

**Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme (në €)**

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitimi/Humbja para tatimit	(751,015)	534,131
Zhvlerësimi	6,539,319	5,305,904
Detyrimet afatshkurtra	111,689	(816,432)
Ndryshimi në kërkesat afatshkurtra	2,308,018	339,534
Të arkëtueshmet tjera tregtare	(402,210)	(1,258,415)
Të hyrat nga grantet	(2,149,196)	(1,562,369)
Lejimet për borxhet e këqija	30,437	869,929
Stoqet	12,368	7,308
<b>Rrjedha neto nga aktivitetet operative</b>	<b>5,699,410</b>	<b>3,419,590</b>
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive</i>		
Pagesat e parasë për blerjen e pasurive jo qarkulluese	(4,834,820)	(4,961,558)
<b>Paratë neto nga aktivitetet investive</b>	<b>(4,834,820)</b>	<b>(4,961,588)</b>
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimet e parasë nga kryegjëja e kredisë, fletë obligacionet, huatë	454,417	1,148,444
Pagesat e parasë për kryegjënë e kredisë dhe fletë obligacioneve	(2,222,000)	(2,222,000)
<b>Paratë neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>(1,767,582)</b>	<b>(803,555)</b>
<b>Rritja /zvogëlimi i parasë gjatë vitit</b>	<b>(902,992)</b>	<b>(2,345,524)</b>
Paraja në fillim të vitit	5,224,092	7,569,616
<b>Paraja në fund të vitit</b>	<b>4,321,100</b>	<b>5,524,093</b>

---

## 3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

---

### Çështja A36 Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese

**Gjetja** Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet ose pasqyrën e rrjedhës së parasë, duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.

Analiza e bërë për shënimet shpjeguese ka rezultuar me çështjet e ngritura si në vijim: zërat financiar në pasqyrën e pozitës financiare dhe pasqyrës së të ardhurave nuk ishin të referencuara me informacionet shpjeguese përkatëse; rezervat kapitale të cilat kishin pësuar rritje nuk ishin mbështetur me informacion shpjegues; tek zëri kërkesat tjera, ekzistojnë vetëm të dhëna numerike pa përshkrime lidhur me përbërjen e këtyre vlerave financiare; tek pasqyra e të ardhurave, zëri "Të dalurat financiare" përmban vetëm përshkrimin shpenzime të ndryshme në vlerë 12,873 pa përshkrim lidhur me përbërjen e tyre; dhe të hyrat e shtyra - Grantet nuk janë prezantuar detaje lidhur me rritjen/zvogëlimin e tyre krahasuar me vitin paraprak.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së vëmendjes gjatë hartimit të shënimeve shpjeguese.

**Rreziku** Mos referencimi i shënimeve shpjeguese me zërat financiar përkatës dhe mungesa e shpalosjeve adekuate, kufizojnë përdoruesit e pasqyrave për ta kuptuar drejt gjendjen financiare dhe afariste të ndërmarrjes.

**Rekomandimi A36** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të shënimeve shpjeguese informatat të jenë referencuar me zërat përkatës dhe me detaje përkatëse sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

## 4 Qeverisja e mirë

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda KRU Prishtina veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja ndaj rekomandimeve të auditimit dhe përcjellja e implementimit të rekomandimeve nga NJAB kanë nevojë për përmirësim.

## 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me katër anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe tre auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të KRU "Prishtina" dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit. NJAB kishte përgatitur planin strategjik dhe planin vjetor të punës bazuar në vlerësimin paraprak të rreziqeve, mbi bazën e të cilave ka kryer auditimet gjatë vitit. NJAB për vitin 2018 ka planifikuar tetë angazhime të cilat i ka realizuar në tërësi.

Përmes këtyre raporteve NJAB i kishte ofruar informata menaxhmentit se sa efektive janë kontrollet e brendshme dhe funksionimi i tyre. Qasja e auditimit të brendshëm ishte e bazuar në rreziqe dhe në ngjarjet aktuale të kompanisë. Komiteti i auditimit kishte mbajtur takime të rregullta dhe kishte shqyrtuar të gjitha raportet e NJAB.

### Çështja A37 Mos përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NJAB

**Gjetja** Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (SNPPAB) 2500.A1 parashohin që Drejtori i NjAB duhet të themelojë procese përcjellëse për monitorim dhe të sigurohet se veprimet e stafit të lartë menaxhues janë zbatuar në mënyrë efektive apo që stafi i lartë menaxhues ka pranuar rrezikun për mos marrje të veprimeve.

NJAB nuk kishte themeluar dhe nuk mirëmban një sistem të monitorimit të rezultateve të komunikuara të angazhimeve, për tu siguruar se rekomandimet janë zbatuar në mënyrë efektive.

Kjo ka ndodhur si pasojë se NjAB e arsyeton monitorimin e zbatimit të rekomandimeve me verifikimin e implementimit në auditimin e radhës.

**Rreziku** Mos përcjellja e zbatimit të rekomandimeve rrezikon mos informimin me kohë të Komitetit të auditimit dhe vonesa në zbatimin e rekomandimeve, të cilat si rrjedhojë pamundësojnë përmirësimin e proceseve të qeverisjes, administrimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit me kohë.

**Rekomandimi A37** Kryesuesi i Bordit nëpërmjet Komitetit të Auditimit të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm në baza periodike të monitoroj rezultatet e komunikuara të angazhimit, për tu siguruar se rekomandimet janë zbatuara në mënyrë efektive apo që menaxhmenti i ndërmarrjes ka pranuar rrezikun e mos marrjes së veprimeve.

---

**Çështja A38 Mos përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të NjAB nga Menaxhmenti**

- Gjetja** Sipas SNPPAB 2440, pasi që Drejtori i Auditimit bënë shpërndarjen e rezultateve të auditimit, sipas pajtimeve në raportin final, është përgjegjësi e menaxhmentit të lartë të ndërmarrjes të përmbushë rekomandimet e dhëna apo të pranoj rrezikun e mos marrjes së veprimeve.
- Menaxhmenti i Kompanisë gjatë auditimit nuk ka dëshmuar se në mënyrë sistematike përcjellë progresin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga NJAB.
- Zyrtarët e ndërmarrjes kanë konsideruar se komentet e dhëna për zotimin e përmbushjes së rekomandimeve në raportet e auditimit të brendshëm si dhe iniciativat individuale të menaxherëve përgjegjës për përmbushjen e tyre janë të mjaftueshme.
- Rreziku** Mos përcjellja e zbatimit të rekomandimeve nga Menaxhmenti i ndërmarrjes, pamundëson përmirësimin e proceseve të qeverisjes, administrimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit me kohë.
- Rekomandimi A38** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që menaxhmenti i ndërmarrjes në mënyrë të vazhdueshme bënë përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas zotimeve në rekomandimet finale.

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë ndërmarrjen.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

### Çështja A39 Mos hartimi i planit për menaxhimin e të gjitha rreziqeve

**Gjetja** Me vlerësimin e rreziqeve si pjesë përbërëse e kontrollit të brendshëm, parashihet që menaxhmenti për të krijuar një ambient efektiv të kontrollit, vlerëson rreziqet me të cilat ballafaqohet entiteti për derisa synon të arrijë objektivat e tij. Ky vlerësim siguron bazën për zhvillimin e përgjigjeve të duhura ndaj rrezikut.

Kompania kishte hartuar Planin e Biznesit për 2018, i cili përmban kërcënimet (rreziqet) e ndërmarrjes, mirëpo nuk kishte hartuar plane për menaxhimin e të gjitha rreziqeve. Prej gjithsej 11 rreziqeve të identifikuara kishte hartuar plane vetëm për menaxhimin e tri rreziqeve.

Mos hartimi i planit për menaxhimin e të gjitha rreziqeve ka ndodhur për shkak të mungesës së vëmendjes së duhur nga menaxhmenti lidhur me këtë çështje.

**Rreziku** Mungesa e një plani adekuat për menaxhim të gjitha rreziqeve potenciale, ndikon në pamundësinë e ndërmarrjes për të reaguar me kohë apo për t'i reduktuar rreziqet në nivele të pranueshme.

**Rekomandimi A39** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se menaxhmenti ka ndërmarrë hapa konkret për hartimin e planit për menaxhimin e të gjitha rreziqeve i cili përmban ndikimin potencial, masat parandaluese dhe veprimet e mëvonshme në rastet kur ato rreziqe materializohen.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të KRU Prishtina ka rezultuar në 20 rekomandime kryesore. Kompania kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Vërehet angazhim në adresimin e çështjeve dhe rekomandimeve të dala në raportin e kaluar të auditimit dhe deri në fund të auditimit tonë, për vitin 2018, zbatimi i rekomandimeve ishte si në vijim: 10 rekomandime janë zbatuar, tri ishin në proces dhe shtatë nuk janë adresuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar faktorët që kanë sjellë në kualifikim të opinionit të auditimit dhe të merren të gjitha veprimet që çështjet të cilat kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të korrigjohen dhe të mos përsëriten.</p> <p>Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, raportet tremujore, raportet e shërbimit të faturimit dhe të kontabilitetit. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-s</p>	<p>1. Ndërmarrja kishte shpallur procedurat e prokurimit për angazhimin e kompanisë kompetente për rivlerësim të aseteve, mirëpo një proces i tillë akoma nuk ishte realizuar për shkak të dështimit të këtyre procedurave.</p> <p>2. Arkëtimet në shënimet kontabël krahasuar me shënimet në modulën e shitjes ishin mbivlerësuar për 91,847€.</p> <p>3. Shënimet shpjeguese nuk ishin të plota dhe të sakta.</p>	Nuk është zbatuar
2	Plani i Biznesit	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se plani i biznesit përcakton objektiva të qarta dhe të realizueshme, si dhe të	Ndërmarrja ka hartuar dhe	Është zbatuar



		bëj rishikime të nevojshme për të vlerësuar nëse objektivat vjetore të planit po realizohen.	rishikuar planin e biznesit.	
3	Llogaritë e arkëtueshme	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se vazhdon t'i përdor të gjitha rrugët ligjore me kohë për rritjen e arkëtimeve nga faturimet e kryera të kompanisë	LLA-te krahasuar me vitin paraprak kishin një rritje për 399,210€ mirëpo marrë parasysh që vlera e LLA nuk ishte prezantuar saktë në PF, nuk mund të verifikohet zbatimi.	I mbyllur i pa zbatuar.
4	Stoqet	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka identifikuar arsyet që kanë sjellur në diferencën e derivateve mes regjistrave kontabël dhe rezervuarve si dhe të siguroj se pajisjet për matjen e derivateve janë sipas standardeve tekniko metrologjike për të evituar mangësitë e identifikuar.	Është blerë pajisja për matjen e derivateve. Ndërsa lidhur me diferencën e naftës lënda është dorëzuar në Krimet ekonomike	Është zbatuar pjesërisht.
5	Pasuritë jo qarkulluese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për regjistrimin dhe rivlerësimin e pasurive me kohë dhe për të siguruar inventarizim të plotë të pasurive.	Ndërmarrja kishte bërë regjistrimin dhe inventarizimi e Fabrikës së Ujit në Shkabaj.	Është zbatuar
6	Paraja	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka analizuar shkaqet e inkasimit të ulët dhe të forcoj kontrollet e brendshme duke u siguruar se janë përdorur të gjitha rrugët ligjore për rritjen e inkasimeve nga faturimet e kryera të kompanisë.	Gjatë vitit 2018 kishte nivel me të lart të inkasimeve.	Është zbatuar
7	Pagat dhe mëditjet	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj së rastet e tilla nuk do të përsëriten në të ardhmen me qëllim që të evitohet pagesa e punonjësve pa kontrata valide. Po ashtu, të sigurohet stabilitet në menaxhimin e kompanisë	Ndërmarrja kishte lidhur kontrata pune me menaxheret e kompanisë.	Është zbatuar.

8	Pagat dhe mëditjet	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë veprime shtesë për ta forcuar kontrollin e brendshëm në proceset e rekrutimit për të siguruar kryerjen e tyre në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi, me qëllim të punësimit të kandidatëve më të suksesshëm.	Gjatë auditimit të vitit 2018 nuk janë identifikuar parregullsi të tilla.	Është zbatuar.
9	Pasuritë jo qarkulluese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme për shpronësim dhe hartimin e saktë të specifikave për projekte para nënshkrimit të kontratave për ekzekutimin e punimeve dhe të respektoj afatet e kontratave për finalizimin e projekteve.	Gjatë vitit 2018 nuk janë identifikuar vonesa në realizimin e projekteve	Është zbatuar.
10	Mallra dhe shërbime	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se njësitë kërkuese parashetrojnë kërkesat me kohë për t'i lejuar zyrës së prokurimit planifikimin dhe inicimin me kohë të aktiviteteve dhe procedurave të prokurimit.	Edhe gjatë vitit 2018 kishte vonesa në dorëzim të kërkesave dhe nënshkrim të kontratave të paplanifikuara në plan të prokurimit. Megjithatë kompania kishte realizim me të mirë të planit të prokurimit në krahasim me vitin paraprak.	Është zbatuar pjesërisht
11	Mallra dhe shërbime	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj menaxhim të mirë të kontratave dhe në rastet kur operatorët nuk iu përmbahen limiteve kohore të specifikuara në kontrata, të aplikohen ndëshkimet për mos përmbajtjen e kushteve të kontratave	Gjatë testimit të procedurave të prokurimit për vitin 2018 nuk kemi hasur në vonesa në realizim të projekteve.	Është zbatuar
12	Mallra dhe shërbime	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj marrjen e të gjitha masave të nevojshme për realizimin e konfiskimit të sigurisë së ekzekutimit të kontratave të shkëputura për mos përmbushjen e tyre nga ana e operatorëve ekonomik.	Nuk kemi hasur në raste tek të cilat është dashur të ekzekutohet siguria e ekzekutimit	Është zbatuar

13	Mallra dhe shërbime	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se blerja e mallrave dhe shërbimeve bëhen sipas kërkesave të Ligjit të prokurimit për të evituar devijimin nga kërkesat ligjore.	Nuk kemi hasur në raste të pagesave për të cilat nuk ishin realizuar procedurat përkatëse	Është zbatuar
14	Pasqyra Financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të marrë masat e nevojshme për të bërë rivlerësimin e kapitalit rezervë për ta vërtetuar vlerën e saktë të tij.	Ndërmarrja kishte shpallur procedurat e prokurimit për angazhimin e kompanisë kompetente për rivlerësim të aseteve, mirëpo një proces i tillë akoma nuk ishte realizuar për shkak të dështimit të këtyre procedurave	Nuk është zbatuar.
15	Shënimet shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroje se gjatë hartimit të PFV-ve, në shënimet shpjeguese duhet të prezantohen informacionet e mjaftueshme për kompaninë dhe politikat e saj, dhe shënime të plota dhe të sakta për secilin zë të pasqyrave financiare, duke i eliminuar të gjitha diferencat e shënimeve shpjeguese me shumat e prezantuara në pasqyrën e pozitës financiare dhe të pasqyrës së të ardhurave.	Ishin shpalosur politikat e rëndësishme kontabël, mirëpo edhe këtë vit shënimet shpjeguese janë përcjell me mangësi të shumta.	Nuk është zbatuar.
16	Qeverisja e mirë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që ka zbatuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili i përcakton veprimet, afatet kohore dhe stafin përgjegjës, dhe se i njëjti azhurnohet në çdo tre muaj.	Është hartuar plani për implementim të rekomandimeve, i cili përmban afatet kohore dhe stafin përgjegjës. Mirëpo nuk ishin adresuar gjitha rekomandimet.	Është zbatuar pjesërisht.

17	Auditimi i brendshëm	Kryesuesi i Bordit përmes Komitetit të Auditimit duhet të shqyrtoj arsyet pse menaxhmenti i kompanisë nuk ka marr në konsideratë rekomandimet e dhëna nga NJAB, si dhe të rritë masat e përgjegjësisë ndaj stafit të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve.	Edhe gjatë vitit 2018 Menaxhmenti i Kompanisë nuk ka dëshmuar se përcjellë progresin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga NJAB	Nuk është zbatuar.
18	Qeverisja e mirë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë masat e nevojshme për identifikimin e dobësive menaxheriale dhe rreziqet potenciale financiare të kompanisë.	Meqenëse rekomandimi është i përgjithësuar për disa fusha të auditimit, ne i kemi trajtuar këto në mënyrë të veçantë dhe për të cilat janë dhënë rekomandime për secilën.	E pa zbatuar por e mbyllur.
19	Qeverisja e mirë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj marrjen e masave të nevojshme për të hartuar dhe miratuar një kod të etikës sipas kërkesave të ligjit për NP-të dhe kodit të etikës që MZHE e ka nxjerrë si model për ti ndihmuar NP-të.	Ndërmarrja ka hartuar dhe miratuar Kodin e Etikes.	Është zbatuar.
20	Qeverisja e mirë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që në ueb faqen e internetit të kompanisë publikohen të gjitha raportet dhe dokumentet që i kërkon ligji për ndërmarrjet publike, për qëllim të transparencës ndaj publikut	Në ueb faqen e ndërmarrjes ishin publikuar të gjitha raportet dhe dokumentet që i kërkon ligji për ndërmarrjet publike.	Është zbatuar.
<b>Nr</b>	<b>Fusha e auditimit</b>	<b>Rekomandimet e vitit 2018</b>		
1	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që po bëhet një rishikim gjithëpërfshirës i regjistrit të pasurive, dhe se janë marrë veprime konkrete përmirësuese në përputhje me standardet e kontabilitetit për: vlerësimin e pasurive; harmonizimin e aseteve në mes regjistrit të pasurive dhe shënimeve kontabël; zhvlerësimin e aseteve sipas SNK-ve dhe regjistrimit e pasurive të marra donacion me vlerën e drejtë të tyre.		
2	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që është bërë harmonizimi ndërmjet gjendjes së konstatuar të stoqeve gjatë procesit të inventarizimit me evidencat kontabël për to, për të siguruar saktësinë e vlerës së stoqeve të prezantuara në pasqyrat financiare.		

3	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që zyrtarët financiar, regjistrimin e veprimeve që japin efekt në disa periudha kontabël, ta bëjnë duke u bazuar në parimin aktual duke siguruar që të hyrat e shtyra ekonomikisht maturohen (realizohen) edhe në periudhat e ardhshme kontabël.
4	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet e menjëhershme për të identifikuar konsumatorët, mjetet monetare të cilëve janë grumbulluar në llogarinë "Pagesat e dyshimta dhe jashtëzakonshme" dhe se u janë zbritur obligimet e papaguara ndaj ndërmarrjes.
5	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për harmonizimin e të dhënave ndërmjet modulit të shitjes me modulën e kontabilitetit, në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i llogarive të arkëtueshme.
6	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet korrigjuese për nën zërat e zërit "Kërkesat tjera", për të siguruar gjendje dhe prezantim të saktë të tyre në pasqyrat financiare.
7	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për t'i korrigjuar gabimet e identifikuar në të dhënat kontabël në mënyrë që të hartohet një prezantim të saktë në pasqyrave financiare. Përveç kësaj, të krijohen mekanizma që regjistri i obligimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.
8	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë veprimet korrigjuese që të dhënat kontabël të jenë në harmoni me gjendjen e borxheve në ATK dhe gjendjen e obligimeve tjera.
9	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë bërë regjistrimet e sakta kontabël me rastin e krijimit të provizionit, duke njohur detyrimet dhe shpenzimet për to për të fituar një rezultat të saktë financiar.
10	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se në listën e aseteve të cilat janë përfituar nga grantet janë përfshirë asetet me vlerën e neto të tyre në momentin e regjistrimit dhe të merren veprime korrigjuese për rastet kur vlera e tyre nuk është njohur saktë si e hyrë e shtyrë.
11	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë krijimin e një mekanizmi që për çdo faturë të korrigjuar në departamentin e shitjes raportohet tek kontabiliteti si dhe është bërë harmonizimi i modulit të faturimit me shitjet e deklaruara.
12	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë bërë korrigjimet në rastin kur borxhi i keq i fshirë në njëri periudhë është arkëtuar në periudhën tjetër.
13	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes akteve të brendshme janë krijuar mekanizma të cilët do të pamundësojnë marrjen e vendimeve pa autorizimin e organeve kompetente.
14	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuar tek rrjedha e parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.

15	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që shënimet shpjeguese të përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.
16	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që kërkesa për raportim të jashtëm të bëhet në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike, që raportet e tilla janë miratuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe se aprovimi dhe dorëzimi i tyre po bëhet brenda afatit të paraparë ligjor.
17	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në modifikimin e opinionit. Po ashtu, të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre. Përveç kësaj, Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft pasqyrave nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD.
18	Pasqyra e Pozitës Financiare	Kryesuesi i Bordit të sigurojë është azhurnuar rregulla për menaxhim të asetëve duke përfshirë procedurat përkatëse të cilat do të shërbejnë si udhëzime të qarta çiftë për komisionet e inventarizimit e po ashtu edhe për stafin e ngarkuar për menaxhim të regjistrit të asetëve.
19	Pasqyrat e Pozitës Financiare	Kryesuesi i Bordit të sigurojë e formimin e një komision për inventarizimin e veturave në mënyrë që të krijohet një regjistër i plotë i automjeteve të cilat janë në përdorim si dhe të bëhet azhurnimi i tyre në regjistrin e asetëve.
20	Pasqyrat e Pozitës Financiare	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që brenda një afati sa më të shkurtër, menaxhmenti të ndërmarrë veprime konkrete për të hartuar dhe futur në zbatim rregullore të brendshme për akontacione apo paradhënie, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat, kushtet, mënyra dhe lartësia e shumës me rastin e kërkesës përkatësisht marrjes dhe kthimit të paradhënies (akontacionit). Përveç kësaj, të sigurojë që brenda një afati optimal shuma e mjeteve që u është dhënë punëtorëve si akontacion të arkëtohet.
21	Pasqyrat e Pozitës Financiare	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes Akteve të Brendshme të fuqizojë kontrollet e brendshme, me anë të të cilave do të rregullohet njohja e të gjitha shpenzimeve nga daljet e materialeve nga depo në periudhën në të cilën kanë ndodhur, që në mënyrë direkte do të rezultojë edhe në prezantimin e saktë të stoqeve në pasqyrat financiare. Po ashtu të siguroj se janë bërë korrigjimet e nevojshme lidhur me stoqet të cilat janë në përdorim.

22	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se korrigjimin e transaksioneve të cilat kanë të bëjnë me të hyrat nga grantet dhe në rastet kur vlera e asteve është zero të mos lejohet zhvlerësimi i tyre.
23	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që në rastet e mos përmbushjes së obligimeve të konsumatorëve në përmirësimin e gjendjes pas vërejtjeve të komisionit, duhet të aplikohen masa konkrete si ndëshkimet ose shkyçjet e tyre, në mënyrë që regjistrimi i konsumatorëve të bëhet në periudhën kur ofrohet shërbimi..
24	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë formimin e një komisioni përkatës për verifikimin e të gjithë konsumatorëve të rinj të regjistruar, për të konfirmuar nëse këta konsumatorë kanë zbatuar vërejtjet e komisionit dhe në rastet kur ujëmatësit nuk i plotësojnë standardet e kërkuara, brenda një afati sa me të shkurtër kohor të bëhet shkyçja e tyre.
25	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që brenda një afati të përcaktuar kohor të shqyrtojë dhe të marrë masat përmirësuese, në mënyrë që të gjithë konsumatorët e evidentuar me emërtimin "NN" të regjistrohen në emër të shfrytëzuesve të shërbimit. Për më tepër, të sigurohet që shuma kreditore e evidentuar përcaktohet për secilin prej tyre dhe se po merren masat e nevojshme për arkëtime.
26	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj hartimin e një plani veprimi për marrjen e masave të ndërprerjes së faturimit në mënyrë paushallë, duke siguruar mënyrën për instalimin e ujëmatësve tek të gjithë këta konsumatorë, afatet kohore dhe masat ndëshkuese për rastet kur nuk bëhet instalimi i ujëmatësve.
27	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që regjistri i konsumatorëve të plotësohet me të gjitha informatat e konsumatorëve, të merren masa ndaj konsumatorëve të cilët nuk i përgjigjen kërkesave për pagesë, të dërgoj vërejtjet dhe në rastet kur konsumatorët nuk i përgjigjen vërejtjeve të aplikohen procedurat përmbarimore.
28	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që me rastin e formimit të komisioneve të përzgjedhjes së kandidatëve të respektohen afatet kohore dhe gjatë periudhës kur këta të fundit janë të angazhuar në komisione, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të delegohen tek stafi tjetër duke u siguruar që puna e tyre të realizohet brenda afateve kohore, siç është përcaktuar me ligj.
29	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes Akteve të brendshme të ndërmarrjes të fuqizoj kontrollet e brendshme, të cilat do të pamundësonin angazhimin e stafit pa proces konkurrues, pagesën e pagave dhe benefiteve tjera pa dokumente mbështetëse (kontrata të punës), si dhe kontratat për punë dhe detyra specifike të lidhen deri në afatet maksimale të lejuara me ligj.
30	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është bërë azhurnimi i Rregullores së pagave të punonjësve, duke përcaktuar koeficientet e pagave bazuar në pozitat, konform strukturës organizative të ndërmarrjes.

31	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes Akteve të Brendshme të ndërmarrjes të fuqizojë kontrollin e brendshme, të cilat do të siguronin respektimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Bordi Drejtues i Ndërmarrjes.
32	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që të bëhen korrigjimet e nevojshme për gabimet e identifikuar dhe të sigurohet që mekanizmat e vendosura të kontrollit për verifikimin e regjistrimeve të transaksioneve të jenë funksionale në mënyrë që gabimet e tilla të parandalohen duke minimizuar mundësin e keq deklarimeve materiale në pasqyra.
33	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që para inicimit të procedurave të prokurimit nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. Përveç kësaj, kriteret teknike duhet të sigurojnë që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë i barabartë dhe jo-diskriminues.
34	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet sigurojë se janë hartuar politika të brendshme për përcaktimin e kufijve minimal të rezervave të naftës si dhe para skadimit të kontratave, brenda një periudhë të përshtatshme kohore, të fillojnë procedurat e prokurimit për të mundësuar lidhjen e kontratave të reja me kohë.
35	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që me rastin e nënshkrimit të çdo kontrate publike të respektohen kërkesat ligjore në mënyrë të plotë dhe me kontratë publike të shpërblehen, vetëm operatorët të cilët kanë përmbushur gjitha kërkesat e specifikuar në dosjen e tenderit.
36	Shënimet Shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se gjatë hartimit të shënimeve shpjeguese informatat të jenë referencuar me zërat përkatës dhe me detaje përkatëse sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.
37	Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Kryesuesi i Bordit nëpërmjet Komitetit të Auditimit të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm në baza periodike të monitorojë rezultatet e komunikuar të angazhimit, për tu siguruar se rekomandimet janë zbatuara në mënyrë efektive apo që menaxhmenti i ndërmarrjes ka pranuar rrezikun e mos marrjes së veprimeve.
38	Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që menaxhmenti i ndërmarrjes në mënyrë të vazhdueshme bënë përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas zotimeve në rekomandimet finale.
39	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se menaxhmenti ka ndërmarrë hapa konkret për hartimin e planit për menaxhimin e të gjitha rreziqeve i cili përmban ndikimin potencial, masat parandaluese dhe veprimet e mëvonshme në rastet kur ato rreziqe materializohen.



---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër konfirmimi



KOMPANIA RAJONALE UJESJELLËSIT SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.

**PRISHTINA**

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2018 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të KRU Prishtina, për vitin 2018 (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do të ju dërgojmë të plotësuar pyetësin për vlerësimin e subjektit të auditimit. Këtë pyetësor do të pranoni me letër përcjellëse të raportit final të auditimit.

Z. Ilir Avdullahu .....

Kryeshef Ekzekutiv

Data: 26.qershor.2019, Prishtinë,

